



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 45, datë 23.05.2013

**PËR
MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN NR. 18, DATË 27.03.2008
“PËR ORGANIZIMIN E TESTIMIT PËR VLERËSUESIT E DËMEVE NË
SIGURIME”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe të pikës 14, të VKM-së nr. 164, datë 28.01.2008 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime”, me propozim të Departamentit të Licencimit e Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloren, nr. 18, datë 27.03.2008 “Për organizimin e testimit për vlerësuesit e dëmeve në sigurime”, sipas tekstit bashkëngjitur.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Enkeleda SHEHI

Ndryshimet në Rregulloren, nr. 18, datë 27.03.2008 “Për organizimin e testimit për vlerësuesit e dëmeve në sigurime”:

Neni 1, pika 4:

bëhet:

“Departamenti Licencimit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga aplikuesit për licencë, i paraqet Kryetarit të AMF-së, listën e personave që do t’i nënshtrohen testimit”.

Neni 1, pika 2:

bëhet:

“Testimit do t’i nënshtrohen dhe subjektet e përcaktuara në pikën 1, të cilët kërkojnë të rinovojnë licencën, nëse Kryetari në bashkëpunim me Departamentin e Licencimit kanë vendosur kalimin e testit”.

Shtohet pika 5:

“Pas miratimit nga Kryetari, njoftimi për testim publikohet në faqen e internetit të AMF-së, të paktën 1 javë përpara zhvillimit të testimit”.

Neni 3, pika 3:

bëhet:

“Komisioni i Organizimit të Testimit, do të përbëhet nga 5(pesë) anëtarë:

- 3 anëtarë nga stafi i AMF-së;*
- 2 anëtarë të jashtëm, profesionistë në fushën e vlerësimit të dëmeve, apo specialistë nga fusha akademike”.*

Shtohet pika 3.6:

“Kryetari i Autoritetit nxjerr urdhrin për ngritjen e Komisionit dhe përbërjen e tij, si dhe datën e orën e zhvillimit të testimit”.

Neni 5, pika 5.1:

bëhet:

“Testimi do të zhvillohet sa here gjykohet nga Kryetari i AMF-së, pas propozimit nga Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit”.

Neni 7 ndryshohet:

7.1 “Shpallja e rezultateve të testimit do të bëhet pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, brenda 5 (pesë) ditësh pune nga data e zhvillimit të testimit”.

7.2 “Testimi quhet i kaluar kur janë grumbulluar 60% e pikëve të testit”.

Neni 9 ndryshohet:

“Të gjithë aplikantët për pajisje me licencë vlerësues dëmsh në sigurime që do të futen në testim mund të marrin informacion në faqen zyrtare të AMF, tek adresa www.amf.gov.al, mbi fushën që mbulon testimi dhe materialet e rekomanduara për përgatitje”.